

AMBIENTI DHE TEKSTI POETIK I AGIM DEVËS THE ENVIRONMENT AND AGIM DEVA'S POETICAL TEXT

VIOLETË BARDHI-ZEQIRI¹ & QIBRIJE DEMIRI-FRANGU²

¹Fakulteti i Edukimit

²Fakulteti i Filologjisë

Universiteti i Prishtinës

Mitrovicë, REPUBLIKA E KOSOVËS

email: letabardhi@yahoo.com; poezia85@hotmail.com

AKTET VI, 3: 340 - 328, 2013

PERMBLEDHJE

Në këtë punim i jam qasur studimit të fenomenit letrar në tekstet poetike, specifikuar për ambientin. Trajtimi i ambientit në letërsi, pikërisht në krijimtarinë letrare të Agim Devës, të cilin e konsideroj autorin e parë në Kosovë, që ambientin e trajtoi në planin artistik; duke e ndarë nga konferencat, seminarët, referatet, dekretet, ligjet etj. Mesazhet e autorit për fuqinë e fjalës artistike, ngjizur në tekstin poetik, për ruajtjen, kultivimin e ndjenjës dhe pastërtisë së mjedisit ku jetojmë, në planin kombëtar dhe njerëzor. Studimi trajton çështje të formës dhe përmbajtjes së këtyre teksteve: "Koha e luleve" dhe "Natyreza". Përbërjen llojore dhe tipin e vjershave si: vjersha rrëfim, bashkëbisedim, këshillë etj. Po ashtu janë trajtuar çështje të kompozicionit, çështje të përmbajtjeve tekstore, konkretizimi i formave dhe përmbajtjeve, karakteri utilitar dhe ai didaktik-mësimor, si dhe delli artistik kryesisht nëpërmjet figurave stilistike, personifikimit e metaforës; nuancat kuptimore të antonimisë së vjershave dhe dukurive natyrore

Fjalët kyçe: ambienti, natyra, vjersha rrëfim, personifikimi.

SUMMARY

In this paper I have approached the study of literary phenomenon in poetic texts, specified for the environment. Environmental treatment in literature, especially in Agim Deva's literary creativity, whom I consider as the first author in Kosova, treated the environment in an artistic plan; apart conferences, seminars, speeches, decrees, laws, etc. The author's messages about the power of artistic word, conceived in the poetic text, conservation, cultivation of feelings and purity of the environment in which we live, in the national and human plan. The study deals with form issues and content of these texts: "Flower Time" and "Natyreza". Deals with diverse composition and verse types: narrative poems, conversation, advice, etc. Issues of composition, textual content issues, the materialization of forms and contents, utilitarian character and utilitarian teaching and artistic vain mainly through stylistic figures, personification and metaphor; semantic tones of antonymy rhymes and natural phenomena.

Key words: environment, nature, narrative poems, personification.

Hyrje:

Agim Deva është shkrimtar i madh i letërsisë për fëmijë. "Ai është krijues i letërsisë urbane, dhe asaj tematike për fëmijë". Ai zhvilloi aktivitetet e tij në Kosovë, Maqedoni, e kudo në viset tjera shqiptare me organizatën që kishte formuar pas

luftës, "Karvanin e shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë". Pos tjerash, Deva është ndër të parët shkrimtarë që krijoi libra ilustrues tematik për ambientin. ë3ç

Këtë ide e kishte ndërtuar pothuajse edhe në gjithë veprat tjera; e përforcon në dy librat e tij

tematik kushtuar ambientit “*Koha e luleve*” (2000), dhe “*Natyreza*”, (2002).

Në përmbledhjet tjera, sidomos ato të periudhës së parë të krijimtarisë letrare të tij, (1968÷1980) Deva himnizon natyrën. Përmes figurës së personifikimit krijon modele, variante për stinët e muajt e vitit, për drunj, lumin, shiun, erën, peshqit, bletën, lulet, pishën etj. Një shembull i mirë është dhënë në vjershën “Bliri” ku përmes krahasimit, autori zgjon asociacione, dhe krijon konotacione të shumta. Këtu kemi një bashkëbisedim të autorit me fëmijët, përmes pyetjeve retorike: pse rri ai bli ditë e natë përbri rrugës pa nevojë? Përmes një daci të personifikuar, autori përgjigjet fëmijëve se blinoshi shtatgatë si milic veturat i ngadalëson dhe shoferët i këshillon, mos t’shpejtojnë se një vajzë shtatë vjeçare çdo ditë këndeji pari shkon në shkollë. ë6ç

Veprën e parë, “*Koha e luleve*”, e bënë me një dedikim, “*Vjersha për fëmijë*”, dhe kontribuon në mënyrë aktive në ruajtjen e mjedisit, sepse thekson: “Të hollat të cilat mblidhen nga shitja e këtij libri do të shfrytëzohen për gjelbërimin e kryeqytetit të Kosovës”ë

Autori specifikon llojin dhe fushën e krijimit, “*Vjersha për fëmijë*”, duke veneruar në aspektin kritik dhe analitik, këtë libër mund ta quajmë poemë për ambientin. Në pikëpamje të kompozicionit, vepra përmban një tufë vjershash pa tituj, që i karakterizon narracioni. Nocioni fëmijë i referohet të gjitha grupmoshave fëmijërore në sugjestionin e autorit, prej foshnjës e cila kur vjen në jetë duhet të pritet me trëndafil, “Kur, t’i hapë sytë-le të shoh fletë, le të dëgjoj atë ditë bilbila”.

Struktura metrike si strofa, rima, vargu dhe figurat e përdorura stilistike e karakterizojnë këtë libër, në mënyrë të veçantë, është një kujdes i plotë i autorit për të ndërtuar edhe formën e bukur. Përmes asociacioneve, autori krijon raporte familjare me mjedisin, kështu që shpesh përdor sintagmën “Nëna NATYRË”, për ta mishëruar më shumë fëmijën me atë që e rrethon. Përmes personifikimit zberthen shumë njohuri, mësim etj; ndërsa përmes paralelizmit ai baraspeshon, dukuri, fenomene e njohuri të

botës njerëzore me ato të botës bimore, mjedisore për të unifikuar botën njerëzore-fëmijërore me natyrën. Kështu: lules duhet t’i japësh uji të pi sepse edhe ajo është fëmijë. Ky paralelizëm ndërjegjëson fëmijën për kujdes të përhershëm ndaj natyrës.

Për ta bërë më interesante dhe edukative veprën, autori përdor kontrastin, kështu dioksid karbonin, copat e letrës, lëvorja e bananes, pluhuri, ndotja e lumit, kontejnerët etj. ia kundërvë lulet, pishat, qershitë etj. Gjithë sendet bashkëbisedojnë me fëmijët: lëvorja e bananes, qershia, dallëndyshja, druvari e rrapi etj. Bashkëbisedimi me natyrën “Okej Natyrë, natyrë okej, ti vetëm rritu-unë të dëfrej... kur ti shkëlqen, edhe unë shkëlqej” plotëson raportin e ndërsjellë fëmijë-natyrë.

Gjërave që e ndotin ambientin, autori ua gjen antonimitë. Tymin e veturave për ta ndaluar, doemos në qytet duhet ta zbresim malin. Të mbjellim nga një dru; çdo dru ta sjell në zog; e çdo zog ta sjell një këngë, e çdo këngë një kënaqësi, ajër të pastër në mushkëri, se çdo gjeth me jetën e vet, pluhurin mbi ty e pret si ombrellë. Fëmijët të dielën kanë pastruar qytetin nga lotët, ia kanë fshirë faqet e blozuara nga tymi; kanë vendosur në vend të çdo letre të mbjellin nga një tulipan. Autori bënë një përshkrim të qytetit dhe fshatit. Qyteti është i ngarkuar me vetura, tym e blözë, pluhur etj. Por fshati është personifikuar dhe metaforizuar, me plepa, kodrat, liqeni, sepse duart e fshatit janë-plepat e gjatë; vetullat e fshatit janë dy kodra të blerta, dhe sy e kanë liqenin me pasqyra të qeta.

Kompozicioni i veprës “*Koha e luleve*” ka formën e përrallave. E karakterizon rrëfimi dhe dialogu. Rrëfimet kanë strukturën e vargjeve, organizuar në strofa. Strofat janë pa tituj, autori drejtpërdrejtë hyn në temë. Këto rrëfime të ndryshme konkretizojnë dukuri, veprime që kanë që të bëjnë me mjedisin, dhe përfundojnë siç përfundojnë zakonisht përrallat.

Qe, kjo një përrallë-një përrallë e gjallë
Tung-
Përralla n’shcallë-dukati n’ballë.ë7ç

Duke dashur që të jetë sikur gjyshi, autori ka krijuar përmes tekstit poetik një raport shumë të afërt me fëmijët. Përralla është më afër të mundshmes së dëshiruar, realiteti është i vrazhdët, i tillë çfarë është i ndotur dhe pastërtia, koha e luleve është koha e të ardhmes, sepse fëmijët janë ardhmëria e shoqërisë dhe njerëzimit. Përmes këtyre krijimeve poetike, autori mëton ta zhvillojë ndjenjën e të bukurës karshi ndjenjës dhe veprimeve të shëmtuara të cilat duhet luftuar përmes dashurisë për të bukurën.

Nuk janë vetëm lulet, drunjtë, kopshtet, mali, mollët që e mbajnë pastër ambientin, por edhe fjalët e mbajnë të pastër ambientin. "Një këshillë, një porosi, e thënë me qëllim të mirë, ngjall karrocet e lopatat, rrugët, parqet na i dëlirë. E kur të plakemi një ditë do të bindemi se kemi mundur të mbesim edhe më të rinj, po ta kishim dashur më shumë blerimin, po t'i kishim ushqyer zogjtë, po të kishim ujitur lulëkuqet. Po të kishim mbjell më shumë shelgje e pisha, po t'i kishim qortuar druvarët që dëmtonin violinat e nënës Natyrë". Është ky mesazhi i vargjeve të autorit i dhënë në mënyrë fort pedagogjike.

Autori e vlerëson pavdekësinë e fjalës së shkruar, por e vlerëson, punën, veprën jetësore të individit. Rinia e përjetshme e kreativitetit personal e kolektiv identifikohet në vargje: "Fëmijë, para Institutit a e keni parë një mal me pisha-si copë malësie, që shkencëtarëve sot u bënë hije?... e ato pisha t'gjata, të blerta, me shokë të vet, e duar të veta, dikur i mbolli vetë Anton ÇETTA".

Koha e luleve:

Në parathënien e librit *Koha e luleve*, (nga miku ka dy fjalë), siç e identifikon ai veten, me një varg pyetjesh shpjegon përmbajtjen e librit. Më bukur e i shëndetshëm është një mjedis i pastër, apo i ndotur? A më mirë të jemi në shoqëri me trëndafila, apo me goma të automobilit të hedhura buzë lumit, -a më të kënaqur do të jemi ta presim një dru, apo ta mbjellim një pishë. Përmes figurës së personifikimit vihet paralelja mes jetës njerëzore dhe natyrës: edhe lulja rritet si fëmija, duhet të ushqehet, edhe peshku mund

të helmohet, prandaj ka simptomat e një fëmije me temperaturë, edhe kukullat janë si fëmijët, simbolika e bukurisë dhe pastërtisë. Autori krijon përgjithshmërinë për hir të idesë së tij. ë7ç

Një lloj vjershe karakteristike për mënyrën e ndërtimit është vjersha rrëfim, në formën e përrallës. Tregimi për një lëvore pjepri që e shqetëson liqenin, përshkrimi i dhomës së fëmijëve, rrëfimi i qershisë, i djaloshit, i Zanës, janë motivime që do të mund t'i trajtonim tregime të gjata, me këtë temë.

"Si pasqyrë liqeni shtrihet, si një përrallë që nuk tregohet. Mirëpo, një lëvore pjepri, bënë liqenin që të pikëllohet. S'e ka më atë bukuri që kishte pak më parë, s'e ka atë mrekulli, ja, është gati për të qarë... një lëvore nga ai pjepër, ja, shoh edhe një copë letër".

"Në dhomën e fëmijëve është si në botën e mrekullive. Aty askush nuk pi cigare, nuk hedhin letrat nëpër dritare. Të gjitha këpucët njësoj shkëlqejnë... as fjalë të ndyta askush nuk flet, aty muzikë gjithsecili dëgjon, askush askënd nuk e qorton-është një parajsë tokësore".

Disa herë këto vjersha me subjekt janë ndërtuar me figurën e personifikimit, një qershi ëndërronte, "Sot pash për herë të parë një pikë loti në beharë! Ëndërronte një qershi shumë kokra për fëmijë. E ai fëmijë me të keq ia ktheu, një degë plotë behar ia preu". Autori paraqet një veprim të keq krahas natyrës, edhe pse ajo na ushqen.

Një ngjarje e pakëndshme është veprimi i djaloshit. "Një djalosh lau veturën në trotuar, shkoj djaloshi e trotuarin nuk e la si që më parë. Djalë i bukur, kryelartë, la pas vetës aq shumë baltë". Jo rrallëherë, autori e ndërgjegjëson receptuesin se jo vetëm pastërtia individuale është e nevojshme për mjedisin, por edhe ajo shoqërore dhe e kundërta jo vetëm ajo shoqërore por edhe ajo individuale për të pasur ambient të pastër e të shëndetshëm.

"Deshi Zana të ajrosë dhomën e vetë si çdo ditë. Deshi t'i çelë pak dritaret, të hyjë ajër e dritë. Pa i hapur mirë i mbylli, se erdhi një erë e keqe. I kishte ndezur mbeturinat dikush poshtë në kontejner. Tymi i zi ngrihej përperjetë. Kaloi aty një

turist, dhe shikonte me çudi. Ai pak qeshi dhe vazhdoi, se qyteti s'është i tij".

E qeshura me ironi, e një turisti shpreh shpirtngushtësinë e tij "se qyteti s'është i tij". Kultivimi kombëtar i pasurive, ruajtja e ambientit tregon shkallën e kulturës së një populli, civilizimin e tij. Prandaj, autori përmes këtij rrëfimi në vargje deshi t'i ndërgjegjësojë receptuesit për rëndësinë e mjedisit si vlerë kombëtare.

Një lloj tjetër i vjershës i përfaqësuar në këtë libër është vjersha rrëfim dhe dialog. Këto vjersha i karakterizon personifikimi i objekteve të natyrës, këtu flasin rrapit, banania, era e ylli, po kështu i karakterizon rrëfimi; por ajo çka i bënë më emocionale dhe dinamike është dialogu. Rrëfimin e bënë autori, ndërsa dialogun druvari dhe rrapit.

"Atje diku në malin tjetër, në atë mal me setër të blertë u nis sot druvari. –*po nga je nisur or mik, me sëpatë e sharrë në dorë? –për në mal-ta pres atë rrap.* Druvari s'ia kupton gjuhën rrapit tonë plotë fletë. Ai e lutë dhe i sqaron, *mbi një shekull unë kam jetë. Nen hijen time të dendur kanë pushuar shumë shtegtarë, në hijen time janë strukur në vapë, të larë në djersë shumë lavëtarë.* Druvari la sëpatën as një trung s'e preu në mal. Pushoj pak nën hije të rrapit, e në shtëpi u kthye ngadalë".

Rrëfimin e bënë autori, ndërsa banania me çupën dialogojnë përmes personifikimit të bananes, autori aludon në kultivimin dhe pasurimin e ambientit, duke zgjuar asociacione në ardhmërinë, qoftë edhe në një kujtim fëmijërie.

Shpeshherë Deva dialogon me dukuritë natyrore dhe objektet, me qëllim për të bërë krahasime për veprime të papërgjegjshme. Era është dukuri natyrore e cila krahasohet më një të çmendur, kur lakon lisa, përplasë derën, pluhurin na e hedhë syve etj. Këtu vihet paralelizmi midis erës dhe veprimeve tona, kur ia mbulojmë natyrës syçkat, bebëzat, qerpikët me hedhurina.

Ylli i personifikuar zhvillon dialog të brendshëm me autorin: "Të ishte Toka çupëza ime, do të shkëlqente si flori, do ta ulja në prehrin, do t'ia krehja flokët e artë. Nuk do të guxonte kush, një letër t'ia hedhë Tokës sime në faqe". Këtu bashkëveprojnë disa figura stilistike si:

personifikimi, krahasimi, metafora, litota, simboli etj.

Vjersha këshillë:

Këtë lloj vjershe e karakterizon intencionaliteti i autorit. Në këtë mënyrë autori përfaqëson qëllimisht konceptet e tij te fëmijët, në formë këshille sentence, aforizmi apo maksime. Autori në rolin e edukatorit, mësuesit, pedagogut synon të jap këshilla ose t'i mësojë fëmijë si të sillen me natyrën, si mos të bëjnë veprime të këqija, gjë që është edhe qëllimi kryesor i letërsisë didaktike (të mësuarit). Natyra del e personifikuar me flokë, qerpikë e faqe.

"Kur një shishe të kokakolës e shuton ti rrugëve kotë, në sy të qytetit një kënaqësi shndërrohet në disa lot. Merre shishen, çun, atëherë edhe hedhe n'kontejner? T'i pastrojmë rrugët, parqet, dritaret, na vjen këto ditë një foshnje e re. A jeni krehur në mëngjes herët, mos ke harruar lules në saksi t'i japësh pak ujë të pijë. Para luleve mos i mbyllni sytë, as para kokrrave të kuqe të qershisë, as para kalaveshit në degë të hardhisë. Se lumi, lulet, kokrrat e ullinjve, rriten, ushqehen me shikim të fëmijëve!

Mos ia bënë ti kurrë natyrës, atë që ajo s'ta bënë ty! Laja faqet për çdo ditë t'i shkëlqejnë qerpikët në sy. Krehja flokët me një krehër, krehër që i thonë kujdes, qyteti është babai yt, t'i hap rrugët çdo mëngjes"!ë7ç

Natyreza:

Siç e ke ti emrin Zana,
E siç ish një Nënë Terezë,
Ashtu edhe kjo tufë këngësh
E ka emrin Natyrezë. ë8ç

Në këto vargje, autori na njeh me emërtimin e librit, që herë e quan "tufë këngësh", e herë, "libër zemërmirë". Libri herë zgjon asociacione të një zogu që cicëron e herë është lojë e vogël që flet pa gojë. Autori është i vetëdijshëm në atë se, është i pari autor i cili trajtoi në letërsi temën për ambientin. Mënyra se si autori i drejtohet lexuesit; shprehja sintagmatike "nëse të ka pëlqyer" përkon me atë të Jul Varibobës drejtuar lexuesit të veprës së tij në shekullin shtatëmbëdhjetë. "Ky libër ka për qëllim

shpëtimin e Tokës sonë nga ndotja. Jam përpjekur ta shkruaj ashtu që të mos jetë i mërzitshëm për nxënës, as për mësues. E kam ditur që po t'ju shkruaj referate apo urdhëresa në faqet që vijnë, ju do ta hidhni librin diku në një skutë, ku shumë shpejt mund ta kap pluhuri. Nëse të ka pëlqyer jepja këtë libër edhe vëllait tënd, motrës, shokut më të mirë që ke, e ndoshta edhe nënës e babait, sepse mjedisi ynë nuk varet vetëm prej fëmijëve, por edhe prej të rriturve". Që në fillim autori tregon se këtë libër ua dedikon fëmijëve e mësuesve, prindërve, shokut, shoqes, vëllait, motrës –gjithë atyre që mund ta duan e ta ruajnë natyrën..

Vjersha diturore:

Këto vjersha kanë përmbajtje njohurish, dhe diturish, përmbushin një nga funksionet më të rëndësishme të letërsisë për fëmijë, funksionin njohës. Përmes personifikimit, autori i njeh fëmijët me natyrën, duke e përshkruar atë si një princeshë. Autori na tregon çka punon uji? Uji është punëtor i madh, magjistar i gjithësisë. Ujit barin, shuan etjen e njerëzve, i lanë fëmijët, rrobat, enët. Nga qielli kur mungon në këto anë, nga qielli bie këtu. Uji lanë veturat, trotuarët, dritaret, kulmet. Bëhet lum e zbret nga malet me shpirt në burim, mbanë në jetë hidrocentralet. Në fund teksti poetik përmbillet me një këshillë, që është një përmblyllje e zakonshme e letërsisë moralizuese.

Ujë, o ujë, si të shpërblej
Na end botës me anije?
Ai kërkon që ta kursejmë
Që të kemi ujë për pije.ë8ç

Në këtë libër që është një tekst shkollor, didaktik-mësimor, dedikuar fëmijëve dhe mësuesve, përmes lojës, njohjes, shpjegimit bëhet edukimi estetik dhe realizohet artistikja. Artistikja realizohet në strukturën metrike të saj, vjersha, vargje, ritmi, rima, figurat stilistike. Ndërkaq pjesa didaktike-mësimore, praktike realizohet në tekstin "Udhëzime për mësuesit", kërkon nga nxënësit që secili prej tyre të tregojë ndonjë rrefim për ndonjë sjellje të pahijshme, që ndikon

në ndotjen e mjedisit tonë" Autori këtu bën rolin e mësuesit për mësuesin...

Përbërja llojore e vjershave është e tillë: vjersha diturore dhe filozofike, me intonacionin shprehës, kryesisht pyetës. Ky intonacion i përcjell shumicën e vjershave, p.sh. çka mbarohet prej ajrit?, çka punon uji?, a mërziten lulet?..., a i dhemb drurit? etj.

Për kë është shkruar ky libër? Në këtë vjershë, autori bashkëbisedon me fëmijët, është ky një bashkëbisedim i shtjelluar. Autori shpjegon në fillim se ky libër është shkruar pikërisht për nxënësit e katër klasave të para të fillores.

Përmes onomatopesë fëmijët shprehin raportin miqësor me autorin, "ah xhaxhi Agim", ndërsa me nocionin shok, ata përafrojnë distancën e autorit duke e bërë moshatar të tyre. Kjo mënyrë bashkëbisedimi me tone të ngadalta shpreh butësinë, kujdesin, dashurinë, çiltërsinë që autori ka me fëmijët. Figura e personifikimit është njëra prej figurave më të përdorura në ndërtimin e tekstit poetik. Janë personifikuar: uji, veturat, natyra, lulja, druri, ajri, oksigjeni dhoma etj. Ato flasin, qeshin, mërziten, flladiten, protestojnë etj. "Protestoi një ditë lulja nga saksia, kush u hedh pluhur gjetheve të mia. Ç'ke që qan moj lule, e pyeti dielli i artë, paj termocentralit ia ka marr inat"

Disa vjersha të autorit, përmes pasthirmave krijojnë emocione të forta te receptuesi, kryesisht fëmijë. Nga forma vjersha është ndërtuar sikurse një pemë, kjo është vjershë emblematike, e përfaqësuar vizualisht: dy vargjet e para janë kurora, pastaj përmes një shkallëzimi ndërtohet trupi i pemës:

"Ne mendojmë se nuk i dhemb drurit tonë të gjatë, kur pa fije mëshire i mëshojmë me sopat"

Një herë
Dy herë
Tri herë
Katër herë

dhe trugu i vjetër me kurorën e vetë madhështore e plotë gjelbërim, si një vigan i plagosur, më në fund pas shiut, të rrahurave,

shtrihet për dhe, duke lëshuar një ofshamë të thellë: O, O, O, O, O, O, O, OH, po ç'të bëra, O Njeri"?! ë8ç

Teksti poetik është ndërtuar shpesh herë në formë sentencash, që shprehin tema filozofike, p.sh. "Ajri është diçka pa të cilin s'mund të jetohet. Duhet të mbrohet nga qelbësirat, nga tymtarët, nga thartësira, nga monoksid karboni, nga tymrat e një kamioni. Prej ajrit mbarohet liria, prej ajrit mbarohet fëmijëria, prej ajrit mbarohet jeta. Me ajër fryhen balonat. Prej ajrit rriten mushkëritë. Ajri është një shok që nuk shihet por kur frynë era ndihet".

Sentencat që janë mbikrijime popullore. "Trimat e ruajnë natyrën, qyqarët e ndotin". Atë që e ruan sot do ta kesh edhe nesër. "Po ta prejme një lis, e prejme me gjithë hije".

Përveç sentencave të krijuara, autori përdor sentenca popullore të popujve tjerë por që kanë vlerë universale dhe lidhen me preokupimin e autorit: "Nëse mendoni një ditë përpara, hajeni një shujtë, nëse mendoni një vit përpara mbilleni një dru; nëse mendoni njëqind vjet përpara; edukoni fëmijët" ë8ç

Përfundim:

Siç është, Buzuku, autori i veprës së parë në letërsinë shqipe, apo Matrënga, autori i parë i vjershës në letërsinë shqipe; Deva konsiderohet autori i parë i tekstit poetik letrar për ambientin në Kosovë. Me këto krijime, ai hapi rrugën krijimit

artistik me temën ambientit, për të krijuar një ambient të pastër, ai e vlerëson dhe e çmon shumë fjalën e shkruar, fuqinë magjike, dhe katarzën shpirtërore të saj e cila ndikon në pastrimin fizik të ambientit.

Përmes këshillave, sentencave, paralelizmave, personifikimeve, simbolikës, autori e realizon misionin e tij të edukimit dhe fisnikërimit, të fëmijët dhe receptuesi në përgjithësi, që gjithherë të jenë në shërbim të kultivimit të natyrës dhe ruajtjes së ambientit.

Bibliografia:

- ë1ç. Berisha, Anton, Teksti poetik, Prishtinë, 1985.
- ë2ç. Bishqemi, Astrit, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë, Elbasan, 2001
- ë3ç. Demiri-Frangu Qibrije, Letërsia për fëmijë, Prishtinë, 2011
- ë4ç. Deva Agim, Zonja e livadheve, Prishtinë, 1968
- ë5ç. Deva Agim, Trumbeta e artë, Prishtinë, 1968
- ë6ç. Deva Agim, Kali ynë lazdran, Prishtinë, 1971
- ë7ç. Deva Agim, Koha e luleve, Prishtinë, 2000
- ë8ç. Deva Agim, Natyreza, Prishtinë, 2002
- ë9ç. Qosja Rexhep, Historia e letërsisë shqipe, Prishtinë, 1986
- ë10ç. Rrahmani Zejnullah, Teoria e letërsisë, Prishtinë, 1996.

